KESB
Kindes- und Erwachsenenschutzbehörde
Bezirke Winterthur und Andelfingen

# KESB SQARON SHKURTIMISHT

Zyra për mbrojtjen e fëmijeve dhe të rriturve (KESB) mbështet njerëzit në situata të vështira. Kjo zyrë vepron në ato raste, kur paraqitet një i ashtuquajtur lajmërim për rrezik. Ngandonjëherë lajmërohen tek zyra për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rriturve vetë të prekurit, ngandonjëherë lajmërohen kushërinjtë, fqinjët, shkolla e fëmijëve ose policia, të cilët mund të behen merak për ju. Specialistët e kesaj zyre kontrollojnë me kujdes pas ardhjes së njoftimit, nëse një fëmijë respektivisht një i rritur ka nevojë për mbështetje.

Zyra për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rriturve (KESB) përbëhet nga tetë anëtarë të autorizuar. Nëse kjo zyrë hyn në veprim, ajo hap një të ashtuquajtur procedurë. Drejtimin e kësaj procedure e merr përsipër një nga tetë anëtarët e kësaj zyre. Sqarimin konkret të çdo rasti të veçantë e merr përsipër nje specialist ose një specialiste. Specialistët mund të jenë juristë, psikologë ose punonjës socialë. Ata ftojnë në zyrë për një bisedë private personat e prekur ose prindërit dhe fëmijën, për të cilin dikush bëhet merak. Zyra për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rriturve dëshiron të mësojë, se si e vlerësojnë situatën vetë të prekurit. Pas përfundimit të kësaj bisede, kjo zyrë mund të marrë informacione të mëtejshme në lidhje me rastin e caktuar, vetëm atëhere nëse këto do ti duken asaj të nevojshme. Ajo mund të pyesë psh. mjekun, shkollën për informacione të caktuara apo mund të kërkojë sqarime në lidhje me situatën familiare nga qendra për ndihmën e fëmijëve dhe të rinjve.

Procedurat tek kjo zyrë zakonisht janë të lidhura me një kosto të caktuar.

Pasi këto sqarime kanë përfunduar, atëherë punonjësit e zyrës për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rriturve, ofrojnë mënyra të ndryshme, që ndihmojnë dhe mbështesin të prekurit, të cilët mund të shfaqin pastaj mendimin e tyre. Pas kësaj tre nga anëtarët e autorizuar vendosin sesi do të veprohet në vazhdimësi pavarsisht nga dispozitat ligjore. Kështu ata vënë në përdorim njohurit dhe dijen e tyre në fusha të ndryshme si drejtësi, punë sociale apo dhe pedagogji. Më tej atë, që anëtarët e autorizuar vendosin, quhet vendim.

Me këtë vendim zyra për mbrojtjen e fëmijeve dhe të rriturve (KESB), nëse është e nevojshme, urdhëron që të merren masa të tjera, p.sh. ajo ngarkon me detyrë një përkrahëse ose përkrahës, e cila/i cili kujdeset këtej e tutje për çështjet e rëndësishme të personit, që ka nevojë për ndihmë. Këta përkrahës mund të jenë punonjës socialë, juristë ose juriste, të cilët punojnë në një organizatë (përkrahës profesionalë), apo mund të jenë dhe persona privatë, si p.sh. nga mjedisi rrethues i personit të prekur.

Ky vendim mund dhe të kundërshtohet: Nëse personi i prekur nuk është dakort me procedurën ose mënyrën sesi procedon zyra për mbrojtjen e fëmijeve dhe të rriturve (KESB), atëherë ajo mund të bëjë një ankesë tek gjykata përkatëse, që në kantonin e Zyrih-ut quhet „Këshilli i rrethit (Bezirksrat)“. Instanca tjetër e lartë ku mund të paraqitet ankesa është gjykata e lartë.

Zyra për mbrojtjen e fëmijeve dhe të rriturve (KESB) Winterthur-Andelfingen është përgjegjëse për banorët e qarqeve Andelfingen dhe Winterthur. Përsa i përket organizimit, KESB Winterthur-Andelfingen renditet tek administrata e qytetit te Winterthur-it. Ndërsa si zyrë administrimi me funksion gjyqësor ajo funksionon në mënyrë të pavarur. Ajo mbikqyret nga drejtoria e drejtësisë dhe drejtoria e punëve të brendshme të kanton-it të Zyrih-ut.

Nëse keni pyetje të tjera, mund të merrni informacione të mëtejshme në lidhje me këtë zyrë në internet në webfaqen www.kesb-wa.ch.